

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Kemi dhe 'Timak China', Çollaku: Karrigen në NATO, qeveria paradite e mban vetë, pasdite ua jep kinezëve
ADRESA	https://piranjat.al/politike/ollaku-kemi-dhe-timak-china-qeveria-karrigen-ne-nato-paradite-e-mban-ve-i104077
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 16:47:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 16:45:01 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4224d6764e2de46d1134f8d0c6dca0c38b649e1eb9bb193082713c4f047e2fc4
TEKSTI	ddedaaf09c09c6726710ffcfa2fa246301e8820b889c2b52d1eb91cd9800a6d2e
PAMJA	517297719424fda5331b676551f1ffb7b2fa47e5b05ae8e566f296458eec0cb9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	977edb4354783a7eb63ed0259ee609ecace27870589ef497ec23333cc0999ea7
E MËPARSHMJA	d07fd3f2b7ebc47ef9fc7dcf3f871fadcaaa0639e0959bdf9cb881bd3cfe5d40
RRËNJA MERKLE	7b2b016d700840f0d00306452beff4854c87a5a9cfd79fec123f45a77e434d02
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/977edb4354783a7eb63ed0259ee609ecace27870589ef497ec23333cc0999ea7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash: **Skenderbej**, sheshin **te macronit** **fëmijë,** Këtë 14 **shkollë** dyert e **shkollës** dyert këtë shtator në **NUK ka** ka tmer **pasur** heshtjen në një **loitar** intervistë

POLITIKE

“Kemi dhe ‘Timak China’, Çollaku: Karrigen në NATO, qeveria paradite e mban vetë, pasdite ua jep kinezëve

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 18:45



Gazetari Basir Çollaku, i ftuar në emisionin ‘Task Force’ me Sonila Meçon në SYRI TV, ka hedhur akuza të forta lidhur me aktivitetin e kompanisë Timak dhe marrëdhëniet e saj të pretenduara me interesa kineze, duke e lidhur këtë situatë edhe me sektorë strategjikë të ekonomisë shqiptare.

Çollaku u ndal te ajo që e cilësoi si ‘damari kinez’ i kompanisë dhe ngriti pikëpyetje mbi investimet e paralajmëruara në sektorin e industrisë ushtarake. Sipas Çollakut, bëhet fjalë për paralajmërime për investime në fusha të lidhura me mbrojtjen.

Gazetari ngriti gjithashtu pikëpyetje lidhur me marrëdhëniet e pretenduara të kompanive kineze me sektorin ushtarak të Kinës, duke përmendur kompanitë Cosco dhe Alibaba. Ai e konsideroi situatën veçanërisht shqetësuese për shkak të rolit të shtetit shqiptar në kompanitë ku, sipas tij, ekzistojnë interesa të përbashkëta.

Më tej, gazetari përdori një metaforë të fortë për të përshkruar atë që ai e konsideron si rrezik për interesat strategjike të Shqipërisë. ‘Pra, qeveria jonë ka një karrige në NATO, të cilën paradite e mban vetë, pasdite ia jep kinezëve’, deklaroi ai.

‘Unë mendoj që kjo është afera që do ta heqë përfundimisht gjumin Ramës, derisa të shkojë të flejë te një kuti tjetër, ndryshe nga banesa dhe qeveria. Ajo që kam për detyrë, pse doli nga kjo, doja ta theksoja... është ky Timaku i famshëm këtu. Një servis që specon domate dhe makina që prodhon në Shqipëri, ka hapur Timak China. Pra, ky është i ri... E ka vetë kjo ortakja e Ronit, e ka shënuar aty, janë nxjerrë, i kam të publikuar... në 2025-ën. Dhe thotë, prisni investime të mëdha në armatime, në prodhime ushtarake, kamionë, dronë, armë. Dhe lë si vend i NATO-s. Nuk e di, Kina nuk është në NATO, ë? Me sa di unë.

Prit se ka një detaj shumë interesant, ka një fakt shumë interesant këtu. Këtë 63-shin ne e kemi propozuar Kinën për KKB si vëllezër të atëhershëm. Ka një marrëveshje me dy kompani, Cosco dhe Alibaba, të cilat janë sanksionuar nga Pentagoni në 2025 dhe 2026, për lidhje me Ushtrinë Popullore Kineze, për spiunazh ushtarak. Tani, në këto rrethana, motra dhe vëllezër të maxhorancës, duhet t'i hapni pak sytë, sepse Roni ka...

Po, sigurisht, e kanë nxjerrë nëpër faqet... transparenca bën interesin vetë... sigurisht, e ndjek të tjera... Natyrisht që po. Dhe të shohim që ajo... trumbeton investime të mëdha...

Kanë model francez, kanë francezët një bashkëpunim me Toyota-n për prodhime të makinave. Toyota vetë nuk prodhon makina për ushtrinë. Dhe këtu, në marrëveshje, pra francezët, kanë bërë marrëveshje me kompaninë që të bëjnë këto modifikimet dhe ata janë, marrëveshja e shkruar, e mbikëqyrur, e njëra-tjetrës është çështje markash. Ne këtu jemi kapur të kapim nëpër varreza të makinave dhe do bëjmë makina ushtarake. Por ajo që mua më duket më shqetësuese është pikërisht kjo. Ky damari kinez i Efetiut dhe ortakës së tij dhe të tjeran, gjë e cila kalon pastaj nëpër link qeveritar, sepse kemi aksioner shteti, qeverinë këtu në këtë mes. Pra, qeveria jonë ka një karrige në NATO, të cilën paradite e mban vetë, pasdite ia jep kinezëve.

Sigurisht, janë tre orë përgjime.

Duke qenë se këta biznesmenë që janë shoqëria e Ronit dhe e Ramës, janë shtrirë në sektorë strategjikë të rezervave të energjisë, ku përfshihet nafta. Janë bërë gati me koncesionet... tek ilaçet. Është drafti gati, pritet të firmoset. Tek shëndetësia, pritet të firmoset drafti, gjithçka e miksuar.

Aeroportin. Pra, në det, në tokë, në ajër. Tek ushtria janë, tek shëndetësia po, në dijeninë time ka një interes nga disa kompani izraelite për bujqësinë, për një 100 mijë hektarë tokë, ende nuk është bërë, le të themi, publike si informacion.

Po tani, në qoftë se do kishte garë, Sonila, ky Roni, Toni dhe shoqëria nuk do i kishin marrë ato. Këta i marrin buxhetin direkt me thela. Garën ku ta gjejmë ne, sepse janë parametrat e ekonomisë së tregut që e shëndoshin ekonominë. Por këtu s'ka garë, ka garë vetëm me Ramën kush vjedh më shumë. E vetmja garë që ekziston aty.', u shpreh gazetari Basir Çollaku në SYRI TV.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 14 Shtator18:44

[**“Pseudodëgjesat e Ramës”/ Kalaja: Në Poliçan u dogjën teserat e PS, nuk kishte ndodhur as me Enverin**](#)

Gazetari Aulon Kalaja ka komentuar zhvillimet e fundit politike në vend, duke analizuar edhe vijueshmërinë e protestës. Në një in...

POLITIKE 14 Shtator18:02

[**Presidenti Bajram Begaj vizitë zyrtare në Emiratet e Bashkuara Arabe: Forcojmë lidhjet politike, ekonomike dhe njerëzore**](#)

Presidenti Bajram Begaj, zhvilloi një vizitë zyrtare në Emiratet e Bashkuara Arabe. Kjo ishte vizita e parë e një Presidenti të R...

POLITIKE 14 Shtator17:49

[**Pesë shkolla në Astir?! Tre vite nga premtimi i Veliajt, asnjë godinë e përfunduar**](#)

Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj, premtoi gjatë fushatës për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023 se në zonën e Astirit ...

POLITIKE 14 Shtator17:20

[**25 mijë euro vetëm pishina/ Email-et dhe dokumentet në dosje, SPAK ia atribuon vilën Belinda Ballukut. Heshtin “Atelier 4” dhe “Green Coast”**](#)

Pishinë “infinity” me pamje nga deti, hidromasazh i konceptuar sipas një hoteli në Santorini, dru “teak” për një...

POLITIKE 14 Shtator17:13

[**Kërcënimi me vdekje i gazetarit Osman Stafa, PD: Klimë gjithnjë e më armiqësore ndaj fjalës së lirë**](#)

Partia Demokratike ka reaguar në lidhje me kërcënimin me jetë ndaj gazetarit Osman Stafa pas publikimit prej tij të pamjeve nga protest...

POLITIKE 14 Shtator16:24

[**‘Kreu i 5D, Erjon Veliaj pret lirinë’, Këlliçi: A do ta mbrojë Gjykata e Lartë zyrtarisht korrupsionin?**](#)

Nga Belind Këlliçi Nesër kreu i 5D pret lirinë, por a do të mbrojë Gjykata e Lartë zyrtarisht korrupsionin?! Me 13 akuza t...

POLITIKE 14 Shtator16:03

[**Braktisi PS për protestën/ Deputetja Marjana Koçeku tregon nëse ka pasur kontakte me Ramën**](#)

Deputetja e pavarur Marjana Koçeku, e cila më herët ka qenë pjesë e kampit socialist, ka treguar detaje nga seanca e parë plenar...

POLITIKE 14 Shtator15:29

[**U largua me bujë nga PS/ Befason Marjana Koçeku: Kam pasur oferta politike, por...**](#)

Deputetja e pavarur Marjana Koçeku ka zbuluar se ka marrë oferta politike nga subjekte të ndryshme, por ka vendosur të vijojë aktivit...

POLITIKE 14 Shtator15:26

[**Tabaku: Mungesa e transparencës dhe konkurrencës po dëmton rrugën e Shqipërisë drejt BE-së**](#)

Deputetja demokrate paralajmëron se procedurat e ndjekura në tenderët publikë prekin drejtpërdrejt tre kapituj të negociatave, nd&...

POLITIKE 14 Shtator14:59

[**Berisha hap dyert e PD-së për ambasadorin e ri të SHBA: Është i mirëseardhur në çdo kohë!**](#)

Lideri i PD, Sali Berisha, ka reaguar publikisht lidhur me ardhjen e e pritur të ambasadorit të ri të Shteteve të Bashkuara të Amerik...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

[**"Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...**](#)

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

[**Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dy...**](#)

Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

AKTUALITET 13 Shtator

[E rëndë në Patos, një person gjendet i pa jetë ...](#)


Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak më parë në Patos. Një person është gjetur i pa jetë në oborrin e bane...

INVESTIGIME 31 Maj 14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Cllevio!





Reagon Cllevio!





Deklarata e Gjestr!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.